



TURGUT ÖZAL
INSTITUCIONET
ARSIMORE

Kolegji TURGUT ÖZAL

BULETIN

Nr. 7 / Prill 2017



*"Një fillim i mbarë
për një të ardhme të sigurt"*

- **Siguri**
- **Disiplinë**
- **Staf me përvojë**
- **Arsim në anglisht**
- **Transport i garantuar**
- **Ushqim i kontrolluar**
- **Aktivitete sportive e sociale**
- **Mundësi akomodimi në konvikt**
- **Metoda e kushte bashkëkohore**
- **Asistencë për studim jashtë vendit**



Redaksia:

Fiqerete Hoxha Romelda Blaceri
Lumturie Gjura Demir Osmani
Suada Kroi Pegi Koci
Entela Quku Desara Qojle
Elsona Okshtuni Kejsi Sulaj

fotograf

Elvis Gjonaj

design

Aldo Rrodotani

Përbajtja



- KOPSHT
9-VJEÇARE
E MESME
- 4-NJË FILLIM I MBARË DREJT SUKSESIT NË TË ARDHMEN
 - 5- PROGRAMI I ORIENTIMIT
 - 6- MUAJI I LETËRSISË
 - 7- ZGJEDHJA E SENATORIT TË SHKOLLËS
 - 8- PANAIRI USHQIMOR
 - 9- KLUBET
 - 10 - BISEDA LETRARE
 - 11- DASHURIA PËR ATDHEUN
 - 12- TAKIME ME PRINDËRIT
 - 13- BINJAKËZIMI
 - 14- TOD TALKS
 - 15- KUJDESI PËR NXËNËSIT E KLASAVE
 - 16- ARTI SKENIK
 - 17- FINALJA E KONKURSIT TË ARTIT DHE LETËRSISË
 - 18- CEREMONIA E MATURES
 - 19- NXËNËSJA JONË BLERTA SHKRELI
 - 20 FESTAT E 28-29 NENTORIT
 - 21- FESTAT E VITIT TE RI
 - 22/23- OLIMPIADAT KOMBËTARE
 - 24- GDS ONLINE
 - 25- EKSURSIONET ME STAFIN
 - 26/27 ESKURSIONE TË NDRYSHME
 - 28- LOJËRAT E INTELIGJENCËS
 - 29- KLUBI "SHPRESA"
 - 30- GLEDIS KALLÇO
 - 31- 7-8 MARSI
 - 32- VIZITAT NË INSTITUCIONE TË NDRYSHME
 - 33- ASEF
 - 34- MUAJI I HISTORISË
 - 35- KONKURSI SHKENCOR
 - 36- BARJOL LAMI PRANOGET NË MIT
 - 37- ANA PEÇINI
 - 38- EGMO
 - 39- OLIMPIADA BALLKANIKE E MATEMATIKES
 - 40- SOLIDARITETI
 - 41- RITAKIM Matura 2016

adresa

Lagja 14.
Mbikalimi i Shkozëtit
Durrës - Shqipëri

cel

+355 69 74 99 292
+355 67 34 04 917

e-mail - facebook

infodurres@turgutozal.edu.al
turgutozaldurresofficial



NJË FILLIM I MBARË DREJT SUKSESIT NË TË ARDHMEN



Mjediset e kopshtit të shkollës "Turgut Özal" u dhuruan të parët mirëseardhjen vogëlushëve. Këto mjedise u zbukuruan më shumë nga ç'i kishin zbukuruar edukatoret, nga lulet që ata mbanin në duar, gumëzhimat gazmore dhe përqafimet pa fund.

Një program përgatitor disajavor do të sillte në shkollën tonë nxënësit e rinj të klasave të nënta dhe të dhjeta në ndjekjen e kurseve intensive për mësimin e gjuhëve të huaja; anglisht dhe turqisht. Ky program do t'i ndihmonë ata ta kishin më të lehtë ndjekjen e procesit mësimor gjatë viti shkollor.

Dita e fillimit të shkolllës do t'i mbushte plot e përplot oborrin, korridoret dhe klasat e kolegjit "Turgut Özal". Nxënësve tanë u lexohej në sy malli për t'u takuar me shoqërinë e vjetër apo dëshira për t'u miqësuar me shoqërinë e re. Të pajisur tashmë me gjërat e duhura për fillimin e viti shkollor (paketat e librave, uniformën e shkollës etj) gjenden në mjediset komode të shkollës sonë të gatshëm për të përballuar me sukses sfidat e një viti të ri shkollor.



PROGRAMI I ORIENTIMIT

(Nxënësit e klasave IX, X dhe XII)

Të gjithë e dimë dhe e pranojmë se nuk është aspak e lehtë të integrohesh e mësohesh në një shkollë të re, me shokë e shoqe të reja, por në shkollën tonë ky nuk është më një problem. Programi i orientimit ju vjen në ndihmë të gjithë nxënësve të rinj të shkollës sonë, duke i njojur me mënyrën e mësimdhënies, pritshmëritë tona e natyrisht duke i ndihmuar në lëndët ku ata hasin vështirësi. Një gjë e tillë bën të mundur që të gjithë nxënësit e kolegjit "Turgut Özal" të ndihen të barabartë ditën e parë të shkollës, duke ecur të sigurt në hapa të suksesshëm...



Skena e kinemasë së madhe

në shkollën "Turgut Özal" ka mirëpritur debate të ndryshme të organizuara kryesisht nga nxënësit e kësaj shkolle. Sot ndodhi ndryshe. Debatuesit nuk ishin më nxënësit gjimnazistë, por studentë dhe petagogë të universitetit "Epoka". Ky debat u organizua në formën e një programi informues: nga njëra anë përfaqësuesit e Degëve të Inxhinierisë (studentë dhe petagogë) dhe nga ana tjeter përfaqësues të Fakultetit Ekonomik dhe të Marrëdhënieve Ndërkombëtare (studentë dhe petagogë). Moderatori Aleksandër Kote, ish-kolegjist në shkollën tonë, tashmë student i ing. së ndërtimit në universitetin "Epoka", u dha kohën e mjartueshme diskutuesve që t'ua bënин të qartë të pranishmëve pikat e forta që ofronin departamentet e këtij universiteti, specifikisht për çdo zgjedhje që nxënësit do të bën. Ndër prioritetet e të dyja palëvë u vu re koordinimi i kurrikulës dhe programeve të universitetit me ato të universiteteve evropiane dhe amerikane. Përvoja e debatuesve sillte raste të programit të shkëmbimit mes tyre, vazhdimit të studimeve master, doktoraturës etj pa asnjë problem në këto universitete. Edukimi, dokumentacioni dhe njohja e gjuhës së huaj janë një pasaportë e sigurt drejt tyre. Në këtë debat iu la hapësira e nevojshme edhe nxënësve maturantë që t'i pyesnin pjesëtarët e panelit e natyrisht të merrnin përgjigje nga këta të fundit. Aktivitete të tilla i mirëpresim dhe në vazhdim.

MUAJI I LETËRSISË

Muaji titorështë cilësuar si "Muaji i Letërsisë". Në vetvete ky muaj mbart shumë vlera, të cilat në shkollën tonë demonstrohen me një larmishmëri aktivitetesh. Konkursi i fjalës artistike, notave muzikore, pikturave në simbole e ngjyra kuq e zi si edhe ese në gjuhën shqipe kanë qenë pjesë e pandashme e këtij muaji. Biseda me shkrimitarët e njohur Z. Vasillaq Papaj kishte një mesazh tepër domethënës për nxënësit e shkollës sonë. Një realizim tepër i veçantë ka qenë edhe improvizimi i "Dhomës Tradicionale Shqiptare", si dhe sfilatës në veshje popullore shqiptare. Është për tu vlerësuar e marrë shembull devotshmëria e nxënësve, të cilët bëhen pjesë e pandashme e këtyre momenteve kaq të bukurë.





ZGJEDHJA E SENATORIT TË SHKOLLËS

"Zgjedhja e senatorit të shkollës", ishte aktiviteti që mblodhi në sallën e kinemasë së madhe të kolegji "Turgut Özal", nxënësit e shkollës së mesme. Ishte finalja e një pune të mëparshme të kandidatëve konkurruesh, të cilët do të prezantonin para zgjedhësve të tyre plan-projektet që do t'i vinin në zbatim në qoftë se do të votoheshin nga nxënësit. I pari u prezantua Revi Kazani, nxënës në klasën XII, i cili premtoi se do ta rigjallëronte shkollën në rast se zgjidhej president i saj. E njihet rëndësinë e të qenit president, sepse e kishte kryer më parë këtë detyrë në një shkollë tjeter. Ligjëruesi i dytë Darien Kadriu, nxënës në klasën XI, theksoi se mundej t'i përgjigjej standardit të shkollës, duke qenë se do të ishte dëgjues i vëmendshëm i bashkëmoshatarëve të tij dhe do të ishte përcjellësi i zërit të tyre në strukturat e shkollës dhe më gjerë. Maturantja Klarisa Duriçi, u kërkoi të pranishmëve mbështetjen e tyre dhe i siguroi se rrugëtimi i saj do të ishte rrugëtimi i të gjithëve së bashku. Ishte shumë bindëse në ato që thoshte dhe në fakt e kishte treguar dhe më parë që ishte bashkëpunuese, këmbëngulëse dhe e suksesshme në realizimin e projekteve dhe aktiviteteve të ndryshme. Gjimnazistët dëgjuan secilin prej tyre dhe më në fund e thanë fjalën e tyrenëpërmjet votës. Fituese u shpall Klarisa Duriçi. I urojmë suksesë senatores së re dhe i kujtojmë që premtimet t'i bëjë realitet!



KLARISA DURIÇI

Shpallet Presidentja e shkollës sonë

JURGUT ÖZAL
INSTITUCIONI PËRSHTABOR



PANAIRI USHQIMOR

Ndihma për njerëzit në nevojë është një detyrim moral për ne. Ndaj në shkollën tonë u organizua një panair ushqimor, i realizuar nga nxënësit e Kopshtit, Parashkollor, Klasat e para dhe të dyta. Gatimet e gatuara në shtëpitë e tyre u paraqitën dhe u blenë nga nxënës dhe stafi i shkollës. Qëllimi ishte i vetëm... Të ndihmojmë fëmijët në nevojë dhe pamundësi ekonomike. Falenderojmë nxënësit pjesëmarrës që kontribuan në këtë aktivitet dhe e bënë këtë ditë mësimi edhe më të bukur dhe të mbushur me vlera morale.



KLUBET

Për një zhvillim të mëtejshëm të prirjeve dhe talenteve të nxënësve tanë, në shkollë janë formuar disa klube. Në këto klube nxënësit përvèçse marrin njohuri ekstra në lëndë të ndryshme, zbaviten dhe kalojnë edhe më shumë kohë me njëri-tjetrin.



Klubi i Anglishtes



Klubi i Basketbollit



Klubi i Informatikës



Klubi i Pianos



Klubi i Vizatimit



Klubi i Violinës dhe Kitarës



Klubi i Fotografisë



Klubi i Shahut



Klubi i Futbollit



Klubi i Kërcimit



BISEDA LETRARE

Leximi i letërsisë së mirë është një përvojë kënaqësie padyshim, por është edhe një përvojë që na mëson çfarë jemi dhe si jemi, në integritetin dhe papërsosmërinë tonë njerëzore, me veprimet tona, ëndrrat tona dhe fantazitë tona, të veçuar dhe në marrëdhëniet që na lidhin me të tjerët, në mënyrën sesi dukemi në publik dhe në thellësitë sekrete të ndërgjegjes sonë. Çdo vepër- një dritare, çdo kryevepër- një portë e madhe e hapur në botën e kulturës. Kjo është magjia e artit dhe letërsisë.

Tashmë në shkollën tonë është bërë traditë që në Muajin e Letërsisë dhe të Arteve çdo paralel te paraqesë ore bisedë letrare të hapur. Kështu klasat e nënta u paraqiten me veprën letrare të shkrimit tarit të madh Ismail Kadare "Prilli i thyer". Nxënësit folën dhe diskutuan mbi gjakmarrijen si një plagë e rëndë e shoqërisë shqiptare. Detaje të këtij fenomeni u pasqyruan edhe me video të përgatitura nga nxënësit si: Riseldo Plloci, Juri Nikolla, Gred Braho, Hortensia Laze. U pasqyruan me imfësi të gjitha figurat letrare nga nxënësja Arnela Halili. E njëjtë gjë u bë me klasat e teta me veprën letrare "Djemtë e rrugës Pal" të autorit Ferenc Molnar. Nxënësit diskutuan së bashku në lidhje me lojërat e asaj kohe duke i krahasuar me ato të ditëve tona.



Ndërsa klasat e shtata analizuan më së miri veprën letrare "David Koperfil" të autorit Carls Dikens. Nxënësit analizuan shumëlojshmërinë e personazheve të veprës. Krahas analizës së librit nxënësit paraqitën në powerpoint edhe aktorët që kanë portretizuar personazhet në film. Gjatë diskutimeve nxënësit shkëmbjen idetë dhe ndjesitë e tyre për stilin e shkrimit tarit dhe historinë e përshkruar në libër.

Për herë të parë nxënësit e klasës së gjashtë analizuan dhe paraqitën me video punën e tyre për librin "Princi i vogël". Kënaqësinë e leximit të librit nxënësit e paraqitën gjatë diskutimeve me njëri-tjetrin. Në sallën e kuqe nxënësit e të dy klasave të gjashta prezantuan punët e tyre dhe shkëmbjen ide. Nxënësja Vesa Quku bëri një përbledhje dhe analizë të hollësishme të "Princit".





DASHURIA PËR ATDHEUN

Ndjenja e kombësisë ka qenë gjithnjë një ndjenjë e fuqishme që na ka mbushur zemrën, na ka frymëzuar shpirtin dhe na ka mprehur vullnetin për t'i shërbyer atdheut me të gjitha aftësitë e mundësitet. Këto kanë qenë disa nga fjalët që kanë prezantuar nxënësit në projektet e tyre kushtuar dashurisë për tokën mëmë. Me një pjesëmarrje masive ata kanë treguar se e kanë të qartë përkatësinë e tyre etnike dhe kanë pohuar njëzëri thënien: "Dashuria për atdheun , ia kalon çdo dashurie tjeter".





TAKIME ME PRINDËRIT

Kolegji "Turgut Özal" respekton dhe vlerëson rolin e familjes në edukimin e fëmijëve. Dhe natyrisht për të arritur një bashkëpunim të vazhdueshëm ne organizojmë "Takime me prindër". Shkolla jonë u ofron atyre mundësinë e pjesëmarrjes aktive në jetën e shkollës dhe kërkojmë mbështetje nga ata për të pasur një vazhdimësi të suksesshme të nxënësve tanë. Faleminderit për besimin dhe mbështetjen tuaj!





BINJAKËZIMI

Bashkëpunim, eksperiencia të reja dhe një klimë e mirë pune kriuar nga disa vite me radhë midis kolegjit "Turgut Özal" Durrës dhe shkollës fillore "25 Maji" Hasanbeg - Shkup. Në veçati, gjësim i madh është për nxënësit e shkollave tona. Bashkëpunimi nëpërmjet përvojave të ndryshme, këmbim të ideve, sjellë kjo me një mision dhe vizion në artin e të qenurit mësimdhënës në edukimin e brezave të rinj. Vizita në orët e mësimit në kolegj në lëndët: Anglisht, Matematikë, Edukim fizik dhe Biologji që janë përcjellë me shumë vlerësimë. Një model i arrirë ky binjakëzim në dobi të gjithave si për nxënësit dhe mësimdhënësit. Shumë pozitivitet e mbi të gjitha shoqëri të reja që sjell performanca të ndryshme të të dy institucionëve arsimore mike. Mbyllur me fjalët e të dyjave palëve me shumë përzemërsi, duke uruar suksese dhe sfiduar me përvaja të reja: - Pa diskutim bashkëpunimi do të vazhdojë dhe jeni të mirëpritur në çdo kohë.





TOD TALKS

Një tjetër nismë e rëndësishme në kolegjin "Turgut Özal" ka qenë edhe ajo e TOD TALKS. Një veprimtari e cila ka si qëllim të mësojë nxënësit të shprehin bukur dhe qartë mendimet e ndjesitë e tyre. Natyrisht është një punë e cila kërkon që të lëmë mbrapa emocionet, të krijojmë vetëbesim dhe t'ju tregojmë të gjithëve se mund ti dalim së bashku në një kauzë domethënëse e aktuale në kohën dhe vendin ku jetojmë. Nxënës të ndryshëm si Kristi Shako, Frensis Koka, Klea Hoxhallari e shumë të tjera guxuan të thoshin hapur mendimin e tyre, duke u mirëpritur nga shokët e shoqet e tyre. Suksese!





KUJDESI PËR NXËNËSIT E KLASAVE TË NËNTA DHE TË DYMBËDHJETA

Në arritjen e suksesit dhe rezultateve të kënaqshme ndikojnë disa faktorë. Që në fillim të vittit shkollor tregohet kujdes i veçantë për ecurinë mësimore të nxënësve gjatë kalimit të tyre nga njëri vit në tjetrin. E në veçanti kujdes tepër i madh tregohet në vitin përfundimtar të ciklit të mesém të ulët, pra për klasat e nënta dhe në vitin përfundimtar të ciklit të mesém të lartë, pra për klasat e dy mbëdhjeta. Krahas preokupimit në të gjitha lëndët që ata bëjnë, prioritet u jepet lëndëve të Provimeve të Lirimit (klasat e nënta) dhe të Maturës Shtetërore (klasat e dy mbëdhjeta). Përveç orëve shtesë që nxënësit punojnë në lëndët; anglisht, matematikë gjuhë shqipe dhe letërsi, herë pas here përgjatë vittit shkollor u nënshtrohen testimeve-provë sipas modeleve të testimeve të Provimeve të Lirimit apo të Maturës Shtetërore. Kjo bëhet për dy arsyen. Së pari nxënësit njihen me modelet e dhëna dhe qartësojnë idetë e tyre në lidhje me strukturën apo mënyrën e formulimit të pyetjeve. Së dyti realizimi i këtyre testimeve shërben si paramëtër matës për rezultatet në këto lëndë dhe kështu në një farë mënyre këto rezultate përcaktojnë dhe fokusimin e mëtejshëm të punës së mësuesit dhe të nxënësít.





ARTI SKENIK

Është kthyer tashmë në traditë konkurimi midis talenteve të reja duke sjellë fitore dhe trofe, jo vetëm në fushën akademike, por edhe në ato fusha me mjaft ndikim si në jetë dhe shoqëri. Një nga eksperiencat më të fundit që u përjetua me shumë emocione ishte pjesëmarria në konkursin e Artit Skenik zhvilluar më 17 dhjetor 2016 në mjediset e kolegjit "TURGUT ÖZAL" Durrës.

Kolegji ynë u përfaqësua me pjesët: "Të gjithë me huqe" klasa XII, "Zbutja e kryeneçes" klasa XI, "Zonja nga qyteti" klasa X, "Borgjezi fisnik" klasa IX, "Mbreti Lir" klasa VIII dhe "Vilhem Teli" klasa e VI.

Një ditë e veçantë dukej që në mëngjes edhe dielli me buzëqeshjen e tij u jepte krahë grupeve të "artistëve" të rinj të pushtonin skenën duke interpretuar përparrë jurisë (aktorëve të vërtetë). Gëzim, thirrje, emocione, brohoritje shoqëronin çdo trupë me shfaqjen e tyre. Njëri pas tjetrit, karaktere të ndryshme personazhesh kalonin dhe ngjiteshin në skenën e magjishme. Prapaskena thërret numrin e radhës, publiku, herë nervoz, here shumë entuziasht ndjek çdo moment komentet dhe mimikat e pjesëtarve të jurisë. Salla gumëzhitë dhe komenton karakteret e personazheve.

Koha fluturon pa e kuptuar aspak, vjen çasti më i vërshtirë, dhe ky ishte momenti i ndarjes së çmimeve. Anëtarët e jurisë nuk harrojnë të urojnë, përgëzojnë dhe falenderojnë për përkushtimin dhe seriozitet në këtë aktivitet.

Shkolla jonë u vlerësua me vendin e pare me pjesën "MBRETI LIR" interpretuar nga klasa e tetë. Përqafime dhe urime për suksesin e arritur. Gjithçka që u arrit është me punën e palodhur të mësueseve: Lumturie Gjura, Elsona Okshtuni, Suada Leka, Fiqirete Hoxha dhe Entela Quku dhe me një dëshirë plot përkushtim të nxënësve të gjimnazit dhe të 9-vjeçares.

SUKSESE NË AKTIVITETE TE TJERA.





FINALJA E KONKURSIT TË ARTIT DHE LETËRSISË

Si çdo vit tjetër edhe këtë vit kompleksi i shkollës "Turgut Özal" në Tiranë mirëpriti konkurrentët e të gjitha kolegjeve në vendin tonë për t'iu bashkuar konkurrimit final në kategoritë përkatëse te: konkursi i këngës, interpretimit, esesë dhe vizatimit. Nxënësit pjesëmarrës ishin të talentuar, përgatitja e tyre e admirueshme dhe mbi të gjitha spikaste dëshira e tyre për të prezantuar sa më mirë veten e në të njëjtën kohë edhe shkollën nga vinin. Një përballje e fortë mes më të mirëve të çdo shkolle, të cilët u vlerësuan nga juri profesioniste, të cilat si gjithmonë shpallin dhe fituesit. Shkolla jonë rezultoi me këto çmime:

Konkursi i këngës:

Vanesa Sono (Klasa X) - Vendi i dytë

Konkursi i interpretimit:

Matina Beqiri (Klasa XI) - Vendi i tretë

Konkursi i esesë:

Sofia Tozaj (Klasa VI) - Vendi i dytë

Dea Adhami (Klasa XII) - Vendi i tretë

Konkursi i vizatimit:

Aldrin Biçaku (Klasa VII) - Vendi i dytë



Finalja e Konkursit të Prezantimit u zhvillua në Shkodër dhe nxënësit tanë treguan një përgatitje serioze për temat e zgjedhura. Edhe në këtë konkurs ne patëm fitues, përkatësisht nxënëset:

Klea Hoxhallari (Klasa X) - Vendi i tretë

Fiorela Marra (Klasa XII) - Vendi i tretë





CEREMONIA E MATURËS

Cremonia e maturës është festa që shënon fundin e rrugëtimit shkollor në kolegjin "Turgut Özal". Duke qenë se është aktiviteti përmbyllës, kemi të drejtën të themi se është më i veçanti. Kjo festë është emocion për të gjithë, është momomenti më i rëndësishëm në jetën e çdo maturanti. Mund, lodhja, argëtimi dhe shpërblimi janë ato që kurorëzojnë këtë finish. Mes emocionesh, përqafimesh e lotësh gjëzimi, maturantët ndajnë kujtimet e tyre, copëzat e jetës shkollore të cilat do t'i ndjekin edhe shumë kohë pas largimit nga kjo shkollë, ashtu siç ka ndodhur dhe me brezat e nxënësve para tyre. Natyrisht të nderuarit e mbrëmjes, ata të cilëve u kushtohej festa, nuk i kursejnë falenderimet për prindërit, mësuesit dhe shkollën në të cilën kanë studuar. U janë mirënlohës për mbështetjen, bashkëpunimin dhë mirëkuptimin ndërmjet tyre. Këta maturantë janë krenarë për çfarë kanë arritur dhe optimistë për atë çfarë duan të arrijnë gjatë studimeve universitare.





NXËNËSJA JONË BLERTA SHKRELI



Këtë Vit të Ri klasës sonë iu bashkua një nxënëse e re, Blerta Shkreli. Ne e pritëm me dashuri dhe ngrohtësi. Në sytë e saj shihnim emocionet e ndrojtjen. Ajo vjen nga një familje që kishte nevojë për ndihmë dhe mbështetje për arsimimin e saj. Ishte kolegji ynë "Turgut Özal" Durrës, i cili i hapi dyert drejt dijes, ngrëtësisë dhe shoqërisë. Shokët dhe shoqet e klasës e pranuan në shoqërinë e tyre duke e bërë pjesë të aktiviteteve

dhe mësimeve. Çdo njëri nga ne mundohet t'ia bëjë sa më të lehtë përshtatjen në klasë. Ne jemi të lumtur që është pjesë e klasës sonë, ku do gjejë ngrëtësinë dhe arsimimin cilësor që meriton çdo fëmijë. Nuk është hera e parë që kolegji ynë qëndron pranë këtyre familjeve, por ai vazhdon të japë kontributin e tij për shoqërinë tonë. I urojmë Blertës suksese dhe mirë se erdhe në klasën tonë!



FESTAT E 28-29 NËNTORIT

Festat e 28-29 Nëntorit janë simbol i bashkimit dhe vendosmërisë së popullit shqiptar. Kjo është një ndër ditët më të rëndësishme në të gjithë historinë, ku brezat e rinj përulen përparrë atyre që sakrifikan për atdheun. E natyrisht edhe nxënësit e shkollës sonë dinë të vlerësojnë e falenderojnë të parët e tyre në një formë tepër të vecantë. Me vargje poezish në gjuhën shqipe, me tinguj muzikorë shqiptarë, me sfilata e valle folklorike, kolegji "TURGUT ÖZAL" festoi edhe këtë vit "Ditën e Flamurit". Një ditë e cila u bë edhe më e bukur dhe e veçantë nga pjesëmarria e të ftuarve tepër të rëndësishëm si Znj. Lindita Mukaj dhe Z. Avni Çuni.





FESTA E VITIT TË RI

Ata të cilët hedhin hapat e parë drejt dyerve të dijes janë pikërisht fëmijët e kopshtit. Ndonëse janë shumë të vegjël për ta kuptuar këtë, që këtu nis sfida drejt rrugës së gjatë për të kërkuar dhe arritur më të mirën për veten. Këtë gjë ata e gjejnë pikërisht këtu në ambientet e kopshtit tonë "TURGUT ÖZAL". Këtu arsimohen dhe edukohen brezat e cilët i premtojnë së ardhmes. Ditet kalojnë shpejt dhe si pa e kuptuar festat e fundvitit trokasin kudo. Gëzimin dhe harenë këtyre festave ua shtojnë edhe më shumë këta fëmijë.



Nuk ka si të ndodhë ndryshe tek i sheh ata kaq të vegjël të performojnë në skenë ku akoma nuk i artikulojnë mirë fjalët. Ne urojmë ti shohim në skena më madhështore drejt diplomimit apo edhe më gjérë pasi dija nuk ka kufij. Për këtë është mjaft i rendësishëm bashkëpunimi midis prindërve dhe mesuesve, pasi kështu në i ndihmojmë fëmijët tanë drejt një tjetër ardhmeje më të sigurt. Kënaqësia që na falin si një energji pozitive për vitin që vjen më shpresën se ditë më të bucura na presin.



Çdo festë për ta është një motiv më shumë për ta bërë kopshtin edhe më të dashur. I gjithë kopshti organizohet në këto ditë festash dhe aq të vegjël sa janë nën drejtimin e mësueseve ata mundohen të japid më të mirën e tyre qoftë në recitim, këngë dhe kërcim. Sa e bukur dhe më entuziazëm mbushet skena! Ata ndriçojnë më shumë se dritat që i rrethojnë dhe në sytë e prindërve të tyre duken si artistë të vegjël. Janë të pashmangshme emocionet dhe kënaqësia që na falin këta fëmijë.



TRADITA

OLIMPIADAT K

BARJOL LAMI Kl.12



ÇMIMI I PARË
OLIMPIADA KOMBËTARE MATEMATIKË
ÇMIMI I TRETË
OLIMPIADA KOMBËTARE KIMI
ÇMIMI I TRETË
OLIMPIADA KOMBËTARE BIOLOGJI
PRANOHET NE MIT

1 5 Ari

2 3 Argjendi

3 9 Bronzi



STEFAN HAXHILLAZI Kl.12



ÇMIMI I PARË
OLIMPIADA KOMBËTARE KIMI
ÇMIMI I TRETË
OLIMPIADA KOMBËTARE MATEMATIKË

ROMELDA BLACERI Kl.11



ÇMIMI I PARË
OLIMPIADA KOMBËTARE MATEMATIKË

GRED BRAHO Kl.9



ÇMIMI I PARË
OLIMPIADA KOMBËTARE MATEMATIKË

ALEKSIA KOLO Kl.10



ÇMIMI I PARË
OLIMPIADA KOMBËTARE MATEMATIKË

REI MYDERIZI Kl.12



ÇMIMI I TRETË
OLIMPIADA KOMBËTARE KIMI
ÇMIMI I TRETË
OLIMPIADA KOMBËTARE MATEMATIKË

FIONA RAMAJ Kl.12



ÇMIMI I TRETË
OLIMPIADA KOMBËTARE KIMI

VAZHDON

OMBËTARE 2017

"Një fillim i mbarë për një të ardhme të sigurt"

Gara ishte e hapur, e vështirë, por e bukur. Fitorja gjithmonë u buzëqesh më të aftëve, të cilët u vlerësuan me çmime e vende nderi. Si edhe në vitet e tjera, të parët janë nxënësit e kolegjit tonë. Kjo na kënaq, njëkohësisht na siguron e na shton besimin për rezultate më të mira në të ardhmen. Me kujdesin dhe punën që bëhet, janë të bindur në rrugën e sukseseve. I falenderoj nxënësit e olimpiadës që treguan sukses të lartë, familjet dhe mësuesit që kanë punuar me nxënësit të cilët vlerësojnë punën dhe talentin e tyre dhe ju uroj suksesë të mëtejshme.

REDI MUHARREMI Kl.11



ÇMIMI I DYTË
OLIMPIADA KOMBËTARE MATEMATIKË

JURI NIKOLLA Kl.9



ÇMIMI I DYTË
OLIMPIADA KOMBËTARE MATEMATIKË

KEJDI DOMI Kl.11



ÇMIMI I DYTË
OLIMPIADA KOMBËTARE MATEMATIKË

ALBA MYSHKETA Kl.11



ÇMIMI I TRETË
OLIMPIADA KOMBËTARE BIOLOGJI

JOVAN SHANDRO Kl.11



ÇMIMI I TRETË
OLIMPIADA KOMBËTARE MATEMATIKË

ELENA BARDHO Kl.12




ÇMIMI I TRETË
OLIMPIADA KOMBËTARE KIMI



GDS ONLINE

Një ndër mundësitë që ofron shkolla jonë në zhvillimin sa me efikas të procesit mësimor edukativ, është edhe ndërthurja e këtij të fundit më zhvillimin e teknologjisë.

Një ndër këto arritje ishtë zhvillimi i quiz-eve dhe testimeve të përgjithshmë online. Ky hap në fushën e teknologjisë ishte një lehtësim i dukshëm i punës së përbashkët mësues-nxënës në arritjen e përvetësimit të njojurive në lëndë të ndryshme. Komoditeti dhe motivimi i nxënësve dhe i mësuesve ishte i dukshëm.





EKSURSIONET ME STAFIN



Përveç ekskursioneve që organizohen me nxënësit, interesdhe kujdesiveçantë tregohet edhe për ekskursionet, të cilat organizohen me stafin e shkollës për të vizituar qytete, qendra muzeale - pika turistike dhe historike, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Të tilla ishin edhe ekskursionet që u zhvilluan me stafin tek "Mrizi i Zanave" dhe në Prizren.





EKSURSIONE TË NDRYSHME







LOJËRAT E INTELIGJENCËS

Shkolla "Turgut Özal" krahas të qenit një burim dijesh për nxënësit, di të jetë edhe një folezë e ngrohtë që u ofron atyre mundësinë të shpalosin talentet e veta e të shkëlqejnë në fusha të ndyshme që dalin jashtë kurrikulës shkollore. Aktivitetë të tillë me synim nxjerjen në pah të aftësive të nxënësve si kreativiteti, shkathtësia etj., janë edhe lojërat e shumëllojshme, ndër të cilat dallohen ato që e kanë bërë shkollën tonë të shquhet ndër vite, lojërat e inteligjencës, si shahu, reverse, mangala, jenga, hanoli, 9-gurëshi, kakuzu dhe scrabble.

Këtë vit shkollor pjesëmarria e nxënësve të të gjitha moshave që mjaft e lartë, gjë që rrëfen për dëshirën dhe interesin e madh nga ana e tyre për t'u përfshirë në aktivitete të tillë dhe jo vetëm. Në të njëjtën kohë provohet talenti që buron ndër breza dhe përkushtimi i drejtuesve të shkollës për të organizuar sa më mirë pjesëmarje të tillë me qëllime çlodhëse, argëtuese e njëkohësisht motivuese për nxënësit

Fituesit e klasave X-XII

Kakuzu

- Sara Palloji (Klasa X) - Vendi i parë
- Redi Muharremi (Klasa XI) - Vendi i dytë
- Zelma Kapxhiu (Klasa XII) - Vendi i tretë

Shah

- Kevin Skarra (Klasa X) - Vendi i parë
- Roxhers Kuka (Klasa XI) - Vendi i dytë
- Barjol Lami (Klasa XII) - Vendi i tretë

Scrabble

- Stefan Haxhillazi ((Klasa XII)) - Vendi i parë
- Xheri Tola ((Klasa XII)) - Vendi i dytë

Fituesit e klasave VI-IX

Shah

- Daniel Nurka (Klasa IX) - Vendi i parë
- Tedi Martopulli (Klasa VIII) - Vendi i dytë
- Xhorxha Rrudha (Klasa VII) - Vendi i tretë

Reversi

- Elma Maliqati (Klasa IX) - Vendi i parë

Mangala

- Besart Bebjja (Klasa IX) - Vendi i parë
- Enkel Shehdula (Klasa VII) - Vendi i dytë

Jenga

1. Jurgen Kastrati (Klasa VI) - Vendi i parë
2. Kleid Mulla (Klasa VIII) - Vendi i dytë
3. Aldrin Biçaku (Klasa VII) - Vendi i tretë
4. Endi Isufi (Klasa IX) - Vendi i katërt

Hanoi

1. Vesa Quku (Klasa VI) - Vendi i parë

9-gurësh

1. Artur Biba (Klasa VI) - Vendi i parë





KLUBI "SHPRESA"

Klubi "Shpresa" me një mision shumë njerëzor që përshkruhet me pak fjalë, por shpërndan e rezaton dashuri, mbështetje dhe shpresë. T'u gjendesh pranë njerëzve në nevojë, një shprehje me një qëllim të rëndësishëm në procesin edukues dhe mjaft bujar, të mësojmë e të ndajmë të mirat materiale, ky një prioritet i shkollës sonë. Këto vlera të ndjekin e shoqërojnë rrugët e jetës se tyre.

T'u japim dorën, të ndihmojmë fëmijë dhe nxënës në nevojë është një ndër detyrat dhe prioritetet tona. Ndjenja që nxisin ndjeshmérinë ndaj nevojave të tjetrit, të jesh pranë tyre qoftë edhe për një moment, t'u japësh mbështetje e të mësosh sa bukur është të tregohesh human.

Nxënësit e shkollës sonë kanë dhënë mbështetjen e tyre duke ndihmuar me ushqime dhe veshmbathje në familjet e zonës së Kenetës dhe "Shtëpinë e fëmijës" Shkozet.

Këto ndihma u ndanë nga vetë nxënësit anëtarë të klubit "SHPRESA" shoqëruar nga nëndrejtori dhe mësuesi përgjegjës për klubin.





GLEDIS KALLÇO



Në ditë të ndryshme mysafirë të veçantë vijnë në shkollën tonë. I tillë ishte dhe ish-nxënësi, maturanti i 2015-2016-ës Gledis Kallço, i cili i shtoi gjallérinë kinemasë së vogël në një tjetër dimension. "Drejt të ardhmes së suksesshme", ishte titulli i materialit që ai kishte përgatitur për maturantët tanë, në të cilin kishte gdhendur natyrshëm rrugëtimin e tij drejt MIT-it (Massachusetts Institute of Technology), universitetit në të cilin ai studion. Pjesë e prezantimit ishin dhe këshillat për të interesuarit që dëshironin t'i vazhdonin studimet jashtë vendit. U bëri të ditur bashkëbiseduesve se çfarë



u nevojitej për të qenë të suksesshëm. Ai veçoi që ata t'i kishin qëllimet e qarta, të ndiheshin të motivuar, të hartonin një plan paraprak dhe pa dyshim që të orientoheshin drejt zgjedhjeve të duhura. Këto këshilla vlenin jo vetëm për nxënësit maturantë, por edhe nxënësit e klasave të tjera. Nxënësit e olimpiadës së matematikës nuk u ndien jashtë vëmendjes së Gledisit. Si dikur që profesorë apo studentë nuk kishin kursyer kohën dhë ndihmën për të në lëndën e matematikës dhe ai gjatë pushimeve në Shqipëri, gjeti kohën të bënte "profesorin" për t'u ardhur në ndihmë nxënësve.



7-8 MARSI

Tashmë është bërë traditë e bukur në shkollën tonë festimi i 7-8 Marsit. Kostumet shumëngjyrëshe i jepin një pamje mahnitëse grupit artistik të shkollës. Këngët kushtuar nënës dhe mësuesve sa të bukura janë aq dhe emocionuese për spektatorët. Në këtë festë si gjithmonë nuk munguan të ftuarit nga institucionet shtetërore. Një grup nxënësish bashkë me grupin e xhirimit, kaluan nëpër këto institucionë për të shpërndarë ftesat dhe për të marrë urimet kushtuar nënave dhe mësuesve në këto data të shënuara. Si në çdo aktivitet ishte mjaft domethënëse dhe përshtësia që u bë nga drejtoresha e DAR Durrës, zonja Lindita Mukaj si dhe nga drejtori i shkollës Tuncer Tiryaki. Një gjë krejtësisht e veçantë e kësaj festë ishte pjesëmarrija e grave të moshës së tretë të "Qendres Sociale" të qytetit të Durrësit. Në rreth të këtyre grave u shtrua dhe një drekë e organizuar nga drejtoria e shkollës, ku u morën mjaft falenderime dhe mirënjojje nga kjo qendër.





VIZITAT NË INSTITUCIONE TË NDRYSHME

Shkolla jonë, përveç synimeve dhe objektivave arsimore, ka për qëllim që t'i njohë nxënësit me institucione të ndryshme shtetërore, me qëllim që nxënësit ta shohin nga afër funksionimin e shtetit ligjor. Për këtë arsyeshkolla organizoi me disa grupe nxënësish vizita në Bashkinë e qytetit të Shijakut, institucionin e Gjykatës së Apelit të qytetit të Durrësit etj. Aty nxënësit panë



Gjykata e rrëthit Durrës

nga afër ambientet dhe punën e gjyqtarëve. Në Shijak, nxënësit u pritën nga kryetari i bashkisë z. Ardiq Kokomani. Në ambientet e këtij institucionit u zhvillua një bisedë miqësore, ku nxënësit u njohën nga afër me punën e kësaj bashkie.



Në zyrën e deputetës Esmeralda Shkjau



Drejtoria Arsimore Durrës



Prefektura Durrës



Bashkia Shijak



Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës



ASEF


ASEF është një konkurs shkencor midis nxënësve të kolegjeve "Turgut Özal". Ky konkurs ka si qëllim të aftësojë nxënësit në kërkime shkencore individuale ose në grup. Ata prezantojnë punimet e tyre përballë një jurie ndërkombëtare, e cila vlerëson më të mirët dhe u jep atyre mundësinë të konkurrojnë në konkurse të ngjashme jashtë vendit.





MUAJI I HISTORISË

Tashmë prej vitesh tradita vazhdon, një traditë e cila shpaloset nën logon e "Muajit të Historisë". Një muaj që mbart krenari për të gjithë, një muaj që na kujton edhe më shumë vlerat e kombit tonë. Gjatë këti muaji në kolegjin "Turgut Özal" nxënësit u sensibilizuan dhe u ndien më krenar se kurrë, teksa zbuluronin me simbole të veçanta godinën dhe klasat e shkollës. Nuk munguan edhe konkurset ndërmjet klasave si dhe vëzhgimi i dokumentarëve me karakter historik. Një falenderim i veçantë shkon për mësuesit dhe nxënësit që ishin pjesë aktive e organizimeve në muajin e historisë.





KONKURSI SHKENCOR

Në muajin prill në shkollën tonë u organizua Konkursi Shkencor ndërmjet nxënësve të klasave të nënta me pjesëmarrjen e nxënësve më të dalluar nga mbarë vendi. Konkurrenca qe e fortë, sepse qe përballje mes "më të fortëve". Morën pjesë 161 nxënës, të cilët provuan njohuritë e tyre në lëndët shkencore dhe logjikë. Për njëzet të parët u ofrua bursë në përqindje të ndryshme.






BARJOL LAMI PRANOHET NË MIT

(Massachusetts Institute of Technology)

"You stood out as one of the most talented and promising students in one of the most competitive application pools in the history of the Institute." Kështu shkruhej ndër të tjera në letrën e pranimit nga MIT, të maturantit të shkollës "Turgut Özal" Durrës, Barjol Lami. Rezultatet e shkëlqyera të arritura në vitet e mëparshme dhe ato të deritanishmet, pikët e fituara nga SAT-i, pjesëmarrjet dhe të qenit fitues në olimpiada të ndryshme, kryesisht në lëndët shkencore, qenë gurë themeltarë në vlerësimin dhe pranimim e tij në këtë universitet elitë të arsimit universitar botëror. Shumëkush e ka ëndërr këtë universitet, Barjolit iu bë realitet. Sukses!





ANA PEÇINI



Një ndër maturantet e sukseshme të vitit 2015-2016 pa dyshim që ishte Ana Peçini. Falë punës sistematike të saj, këmbënguljes, pasionit dhe dëshirës për të kapur majat, ajo sot me të vërtetë ndihet krenare për çfarë ka arritur dhe për pritshmëritë në vazhdim. Studente tashmë, ajo mbart me vete dhe kujtimet e bukura nga kolegji "Turgut Özal" Durrës, sukseset e arritura në konkurse e esesë, garimet e shumta në olimpiadat e matematikës kombëtare dhe ndërkombëtare, projekte të ndryshme etj. Këtyre arritjeve ajo do t'u shtonte rezultatet e shkëlqyera në provimet e maturës me vlerësimin maksimal në lëndën e letërsisë dhe matematikës (Në provimin e letërsisë që maturantja e vetme që u vlerësua me notën 10.00). Urojmë që në të njëjtat maja e pse jo akoma më lart ta shohim sërisht Anën.

100%
PIKË



EGMO

Matematika nuk është thjesht një shkencë e natyrës. Ajo është një SHKENCË MBI NATYRËN. Është e vjetmja që na ndihmon të gjejmë rregullin në kaosin që na rrethon. Këtë e dinë shumë mirë vajzat e ekipit shqiptar të EGMO 2017 (Olimpiada Europiane e Matematikës për femra), Romelda Blacëri dhe Aleksia Kolo, të cilat përfaqësuan vendin tonë në Zürich të Zvicrës, në një kompeticion që zhvillohet mes vajzave jo vetëm nga Europa, por edhe nga shumë vende të tjera të botës, që nga viti 2012. Ky konkurs ka si qëllim të theksojë rolin e femrës dhe inteligjencën e saj të padiskutueshme në një disiplinë që është kryesuar historikisht nga meshkujt. Shqipëria ka marrë pjesë tri herë në këtë olimpiadë. Viti 2017 rezultoi tepër i suksesshëm, pasi vendi ynë u kthye me dy Medalje Nderi nga nxënëset e shkollës sonë Romelda dhe Aleksia, të cilat i përgëzojmë pa masë. Është rezultati më i mirë që kemi pasur në tri vite, duke u klasifikuar si vendi i 37-të nga 44, me pikë më të larta edhe se Spanja, Finlanda dhe Luksemburgu.



Për të arritur në këtë konkurs ku mund të shkojnë vetëm katër vajza nga secili shtet, duhet të kalohen një sërë fazash seleksionuese, të cilat përfaqësueset e ekipit shqiptar i kanë kaluar me durim dhe një përgatitje dinjitoze. Këto organizime janë zhvilluar nga Shoqata Shqiptare e Matematikës, nën kujdesin dhe drejtimin e profesor Adrian Naços, i cili shoqëroi vajzat në EGMO 2017, nga data 6 deri në 12 prill.

Kjo olimpiadë përfshiu konkurimin dy-ditor në të gjitha fushat e matematikës: algjebër, gjeometri, teori numri dhe kombinatorikë. Pas publikimit të rezultateve u mbajt një ceremoni madhështore në Universitetin e Zürich-ut, ku u ndanë certifikatat dhe medaljet fituese. Vlen të përmendet se vendet me performancën më të lartë ishin SHBA-ja, Ukraina dhe Rusia.


Për sa u përket kompetacioneve të matematikës në të gjithë botën, çdo pjesëmarrës ka pasur mundësinë jo vetëm të shprehë veten, por të vizitojë vende e të njohë njerëz që merren me të njëjtën fushë. Duke i dhënë kësaj të fundit një rëndësi që e meriton, mjafton të themi se falë saj patëm mundësinë të njohim suksesin dhe të kuptojmë se është më e lehtë ta mësosh matematikën se sa të jetosh pa të.



OLIMPIADA BALLKANIKE E MATEMATIKËS

Olimpiada e matematikës ka qenë dhe vazhdon të jetë një prioritet për kolegjin tonë. Kjo shfaqet në rezultatet e arritura në fazat kombëtare të kësaj olimpiade nëpërmjet çmimeve të shumta që nxënësit tanë kanë arritur të fitojnë. Pas fazës së fundit në rang kombëtar ku kolegjistët tanë fituan plot 4 çmime të para, 3 çmime të dyta dhe 3 çmime të treta, u krye një provim përgjedhës për Olimpiadën Ballkanike të Matematikës (BMO). Nuk kishte si të mungonte dhe këtu paraqitja mjaft e mirë e tyre. Në ekipin e përbërë prej 6 anëtarësh që do të përfaqësojë Shqipërinë në këtë kompeticion mjaft prestigjoz, 3 prej tyre janë maturantët e kolegjit tonë, përkatësisht: Stefan Haxhillazi, Barjol Lami dhe Rei Myderizi.

Këto arritje na bëjnë të gjithëve krenarë për nxënësit tanë dhe u urojmë atyre plot suksese në sfidat me të cilat do të përballen në të ardhmen.



STEFAN HAXHILLAZI



BARJOL LAMI



REI MYDERIZI





SOLIDARITETI

Në shkollën tonë krahas aktivitetave të ndryshme shkencore, kulturore dhe sportive, organizohen edhe konkurse me tematikë sociale-shoqërore. I tillë ishte dhe konkursi me temë "Solidariteti". Konkursi u realizua me prezantime të nxënësve, të cilët nëpërmjet fakteve, argumenteve, përvojave e shembujve konkrete mbrohin qëndrimet e tyre të veçanta në lidhje me temën. Nxënësit pjesëmarrës ishin:

1. Adela Maho
2. Xhulia Quku
3. Pegi Koçi
4. Genc Isaku
5. Blerina Abdaj
6. Ejona Roshi
7. Aurora Kapo
8. Briana Bërdufi




Në prezantimet e tyre ata theksonin se njerëzit në një mënyrë a në një tjetër përfshihen në forma apo kauza të caktuara të ndërveprimit, bashkëpunimit e bashkërendimit të veprimit tararive të tyre për arritjen e një qëllimi të përbashkët. Gjithkush ka diçka për të dhënë nga vetja, pavarësisht masës së saj.

Në fund të konkursit, siç ndodh gjithmonë u shpallën dhe fituesit:

Vendi i parë: Pegi Koçi

Vendi i dytë: Adela Maho

Vendi i tretë: Genc Isaku





RITAKIM MATURA 2016

Lidhja e nxënësve më shkollën ku ata mbarojnë studimet në kolegjin tonë nuk mbaron me përfundimin e ciklit shkollor. Kjo lidhje është e fortë, gjithmonë e pranishme dhe përherë e dëshiruar të realizohet më shpesh në formën e ritakimeve mes ish-nxënësve të brezave të ndryshëm apo të të njëjtë brez. Drejtoria e shkollës u hap atyre dyert e mikpritjes në mjediset e shkollës apo dhe në mjedise të tjera jashtë saj. Ishte muaji dhjetor ai që bashkoi sërisht si dikur nxënësit maturantë të 2016-ës. Kuptohet kishte edhe mungesa. Të gjendur tashmë në universitete të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit jo të gjithë patën mundësi t'i përgjigjeshin me pjesëmarrje ftesës së aktivitetit. Në memorien e të pranishmëve shfaqen çfarë kanë përjetuar më parë dhe si e shohin të kaluarën shkollore nga këndvështrimi i tanishëm studentor. Bisedat e këndshme, atmosfera festive duke qenë se ishte prag festash dhe notat e humorit i jepnin gjallëri kësaj veprimtarie që do të donim të zgjaste pambarimisht.





KLINIKA “OHRI-MEDICAL”

Tiranë

(Fizioterapi, Ortopedi, Neurologji
Traumatologji, Reumatologji)



Trauma sportive
(minisqet, ligamentet,
tendinat)



Fango terapi




Ushtrime terapeutike



Koreksione të shtyllës
kurrizore



Taping



Hernie diskale
(cervikulare,
lumbar)

DIAGNOZAT

- Spondiliatroza
- Gonartroza
- Koxoartroza
- Hernie Diskale
- Lumboishialgji
- Bursit
- Periartrit
- Pareza, Paraliza
- Posttrauma
- Probleme muskulare
- Kontrakttime
- Dëmtime sportive
- Skolioza, kifoza



Tekarterapi



Elektroterapi

TRAJTIME

- Elektroterapi
- Shock wafe terapi
- Hr (tekar) terapi
- Lazer
- Fangoterapi
- Kinezioterapi
- Masazhe
- Magnetoterapi
- Traksion
- Limfodrenazhë
- Hipertermia
- Anticelulit



Short wave



Ultratinguj



Limfodrenazhë



LD tek kanceri i gjirit



Magnetoterapi



Traksiioni cervikal & lumbar



Shock wave

Rruga e trenit

**KLINIKA
OHRI-MEDICAL**

Adresa:
Rruja "Jordan Misja"
Pallatet GENER-2, Tirana
(Pranë Gjykatës së Krimave të Rënda)
Tel: 044506986
Cel: 0699769207

E-mail:
ohrimedical@yahoo.com
info@ohrimedical.com

Website:
www.ohrimedical.com
 fizioterapisë "Ohri-Medical"

Gjykata e Krimave
të Rënda

Burgu

**KLINIKA
OHRI-MEDICAL**

www.kastratigroup.al

Dhe makina jeton gjatë...



KASTRATI
GROUP

 **SHMEL**
EXPRESS

Në rrugën tuaj, kudo...

NË ÇDO PIKË KARBURANTI KASTRATI



Mercedes-Benz
The Best or Nothing



www.continentalvora.al e-mail: info@continentalvora.al



Auto Star Albania sh.a

Autostrada Tiranë-Durrës Km. 7, Kashar, Tiranë tel: +355 44 500 333 fax: +355 44 500 333 email: info@autostar.al web: www.autostar.al

ALBSIG ju kthen buzëqeshjen

Adresa: Rr. George W. Bush, Nr. 10 Tiranë, Albania
Tel: +355 4 2254764

**Albsig**
SHOQERI SIGURIMESH



HARMONIA

HOTELS GROUP



CONTACT US

📞 +355 52 262 240

📞 +355 67 20 61 003

✉️ info@harmonia-hotels.com

🌐 www.harmoniahotelsgroup.com

🏡 Str. Rruga e Kompleksit, km 3, Golem - Durrës